



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

PROCESVERBAL

**KONSULTIM PUBLIK PËR PROJEKT-BUXHETIN E VITIT 2025 PËR LAGJET
ADMINISTRATIVE NR.1 DHE NR.2**

I mbajtur më 31.10.2024, në orën 16:30, në dëgjesën me banorët e Lagjeve Administrative Nr.1 dhe Nr.2, në lidhje me projekt-buxhetin e vitit 2025.

Takimi u zhvillua në Stadiumin Kamëz.

Të pranishëm në takim ishin:

- Kryetari i Bashkisë së Kamëz, Z. Rakip Suli;
- Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Znj. Elisa Spiropali;
- Deputetja e zonës, Znj. Lindita Nikolli;
- Administratorët e Lagjeve Administrative Nr.1 dhe Nr.2, Znj. Blerta Matraku dhe Z. Petrit Marku;
- Kryetari i Këshillit Bashkiak Kamëz, Z.Hysen Koldashi;
- Anëtarët e Këshillit Bashkiak Kamëz ;
- Ndërlidhësit me komunitetin;
- Qytetarët e zonës.

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të administratores së Lagjes Administrative Nr.2, znj.Blerta Matraku, ku i njohu qytetarët për qëllimin e takimit. Më pas fjala i kaloi deputetes së zonës, znj.Lindita Nikolli, e cila pasi falënderoi pjesëmarrësit, Kryetaren e Kuvendit, znj.Elisa Spiropali dhe Kryetarin e Bashkisë Kamëz, z.Rakip Suli, u ndal tek investimet e bëra në Bashkinë Kamëz. “Investimet e bëra në këto 5 vite nga Bashkia Kamëz në arsim, infrastrukturë, ujësjellës-kanalizime nuk janë investuar në 30 vite. Fjala e mbajtur, puna me përpulësi dhe respekt, shërbimi pa i ndarë njerëzit në të majtë dhe të djathtë, por duke i bashkuar, janë virtyte që tashmë janë kthyer në standard, jo vetëm të kryetarit Rakip Suli, por për të gjithë skuadrën e mrekullueshme të

Bashkisë Kamëz. Vjen një ditë siç është kjo e sotmja, ku bëhet transparenca dhe llogaridhënia, ku Rakip Suli është ballëlartë përpara të gjithë atyre që besuan dhe votuan atë, sepse gjithçka që ai ka premtuar, çdo ditë po bëhen realitet”, u shpreh Nikolli.

Më pas fjalën e mori kryetari i Bashkisë Kamëz, z.Rakip Suli, i cili falënderoi Kryetaren e Kuvendit, znj.Elisa Spiropali, deputeten e zonës, znj.Lindita Nikolli dhe të gjithë pjesëmarrësit. Gjatë fjalës së tij, kryetari Rakip Suli u ndal tek investimet e bëra nga Bashkia Kamëz. “Gjatë këtyre viteve në Bashkinë Kamëz janë realizuar investime të jashtëzakonshme që as nuk imagjinoreshin. Investuam në 40 objekte arsimore, 18 shkolla, 16 kopshte dhe 6 çerdhe. Një vëmendje të veçantë i kemi kushtuar familjeve në nevojë, pensionistëve, invalidëve, kryefamiljareve femra me më shumë se një fëmijë, duke ulur barrën e shpenzimeve me reduktimin e taksës deri në masën 0 lek, për këtë kategori. Ndërkohë të gjitha taksat familjare në Bashkinë Kamëz janë ulur me 60%. Një familje në Kamëz i paguan vetëm një cigare në ditë taksë Bashkisë Kamëz për ndriçim, gjelbërim, pastrim, rrugë etj. Pra vetëm 6 mije lek në muaj dhe merr një gamë të gjerë shërbimesh. Më duhet të përmend dhe investimet në ujësjellës dhe kanalizime. Kamza ka patur shumë probleme me përmytjet sepse nuk ishte investuar në infrastrukturën nëntokësore, dhe për këtë arsye Kamza përmytej çdo vit. Ne investuam 125 km rrjet kanalizimesh duke shpëtuar njëherë e mirë nga përmytjet”, deklaroi Suli.

Më tej kryetari Rakip Suli u ndal edhe te rindërtimi, duke theksuar se e pamundura në dukje u bë e mundur falë mbështetjes së Kryeministrit Edi Rama. “Falë mbështetjes së Kryeministrit Edi Rama, i kthyem shpresën Kamzës. Rindërtuam 426 banesa individuale, 19 pallate me 270 apartamente, duke bërë të pamundurën për familjet e prekura. Sot shtëpitë e tyre janë më të sigurt, më të forta dhe më të bukura se më përpara. Për të gjitha familjet që e kanë të pamundur mbulimin e shpenzimeve të qirasë, Bashkia Kamëz ju ka ardhur në ndihmë, duke i trajtuar me bonus qiraje, pasi për ne është shumë e rëndësishme mirëqenia e çdo familje në Kamëz. Ky është ndryshimi dhe kjo është vlera e votës që marrim nga qytetarët”, u shpreh kryebashkiaku Suli.

Punët e bëra në këto 5-vite

➤ Investimet 2019-2024, Bashkia Kamëz

- 40 objekte arsimopre, nga të cilat :
 - Në Lagjen Nr.1 - 8 objekte arsimore, 3 shkolla , 3 kopshte, 2 çerdhe.
 - Në Lagjen Nr.2 - 6 objekte arsimore, 2 shkolla , 2 kopshte, 1 Çerdhe, 1-Gjimnaz
- Infrastrukturë rrugore 195km, nga të cilat:
 - Në Lagjen Nr.1 janë investuar 36.8 km rrugë
 - Në Lagjen Nr.2 janë investuar 36.8 km rrugë
- Ambjente sportive
- Kanalizime 125 km
- Ujësjiellës 195 Km
- Rindërtimi nga tërmeti : 426 banesa individuale
- Pallate Valias : 19/270 apartamente
- Rehabilitimi i pallateve: 54 pallate / 831 familje përfituese
- Parku i Liqenit të Paskuqanit.
- Ndërtimi i Shëtitores së Bathores.
- Krijimi i stacionit zjarrefikës në Valias.
- Blerja e makinave të pastrimit të qytetit.

➤ Të Rinjtë

- 630 bursa ekselence.
- 162 ekupe sportive / 1550 të rinj.
- Panairi i Librit “Kamza Lexon”.
- Klubi i Librit.
- Konkurse artistike për të rinjtë.
- Këshilli Rinor.

- Praktika Pune.
- Kurse profesionale.
- Karta e studentit.

➤ **Taksa dhe Tarifa vendore**

- Tarifa 0 për çdo biznes të ri (për 1 vit), nga 28.000 lek/Viti në 0 lek/Viti Viti 2021-2024 (1519 subjekte perfituese).
- Ulja e tarifave dhe taksave me 60 % Viti 2022-2024 (3978 subjekte përfituese).

Kategoritë	2019	2024
Pensionistët	6000	1200
Invalidet e punës, të verbërit, paraplegjik dhe tetraplegjik	6000	1800
Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike	6000	0
Familjet që trajtohen nga PAK	6000	2000
Kryefamiljare femra me më shumë se një fëmijë	6000	1800

- Numri i përfituesve nga ulja e taksës familjare për vitin 2023

Përfitues 2023	
Ndihme ekonomike	528
Invalid	1453
Pensionist	2225

➤ **Politikat Sociale**

- Taksa 0 për familjet në nevojë .
- Kopshte/çerdhe pa pagesë, 500 fëmijë.
- Qendra Multifunksionale, 99 fëmijë.
- Familje me bonus qeraje nga strehimi social 752.

- Kredi të buta 74 familje .
- Rehabilitimi i banesave.
- Punësimi i personave me aftësi ndryshe.

Investimet e parashikuar në projekt-buxhetin e vitit 2025 për Lagjet Administrative Nr.1 dhe Nr.2

- Në Lagjen Nr.1, infrastrukturë rrugore 14,8 km, 61 rrugë
- Në Lagjen Nr.2, infrastrukturë rrugore 28.7 km, 129 rrugë
- Shkolla 9-vjeçare “Angela Merkel”
- Gjimnazi “Sulejman Elezi” Laknas
- Shëtitorja Frutikulturë
- Fusha sportive Valias
- Rikonstruksioni i Pallatit të Kulturës “Artan Cuku”
- Godina e Bashkisë Kamëz
 - Godina e re do të ndërtohet në fushën e stadiumit të Kamzës
 - Godina e re e Bashkisë do të jetë 3-re kate dhe do të ketë mbi 2000 metra katrorë sipërfaqe;
 - Me parkim nëntokësor;
 - Me hapsira rekreative.

Më pas fjala i kaloi Kryetares së Kuvendit dhe drejtueses politike të Qarkut, znj.Elisa Spiropali e cila pasi falënderoi pjesëmarrësit vuri theksin tek investimet e bëra në Kamëz. “ Ishit shumë frymëzues Kryetar . Unë konstatoj me shumë kënaqësi, se ti ke të njëjtin entuziazëm që kishit që në fillim. Nuk e keni humbur në asnjë çast vizionin për të bërë punë dhe pa i ndarë njerëzit në të majtë apo të djathtë. Është shumë i rëndësishëm ky ballafaqim me qytetarët në mënyrë që, dhe kryetari i Bashkisë z.Suli, edhe ne që e mbështesim të jemi krenarë për punët e bëra dhe kokëllartë përpara qytetarëve. Më përpara ishte mendësia se të gjithë politikanët janë njësoj, por jo nuk janë të gjithë njësoj. Rakipi nuk është njësoj me atë që ka qenë përpara. Rakipi nuk është njësoj as me disa kryetar të tjerë Bashkie që nuk e kanë të njëjtin vizion dhe pasion siç e ka Rakipi për të punuar. Nëse vota do të ishte njësoj, sot nuk do të ishin bërë 40 objekte arsimore në Kamëz, nuk do të investohej në rrugë, ujësjellës dhe kanalizime, nuk do të ishin ulur taksat etj. Ka patur një paragjykim për Kamzën për sa i përket elektoratit, por në zgjedhjet e 2023-it Kamza ia dha votën Rakip Sulit, duke thyer mitin me 12 mijë vota plus. Mbështetja për Rakipin dhe këtë

komunitet nuk do të mungojë as nga Kryeministri, as nga Lindita dhe as nga unë, sepse kënaqësinë që ndjej kur vij këtu nuk e ndjej askund tjetër. Sot në Kamëz është më mirë t'i çojmë fëmijët në kopsht publik se sa në privat, sepse janë të ndërtuara me të gjitha standardet e kushtet më të mira. Kur kaloja në 2021 nëpër disa lagje në Kamëz, as nuk do e besonte njeri se ato lagje do të bëheshin krejt të reja, dhe Valiasi është shembulli më i mirë i rindërtimit, ne nuk i lamë njerëzit vetëm në një fatkeqësi të tillë. Procesin e rindërtimit e kthyem në një proces transformues me banesa më të sigurta dhe akoma më të bukura seç ishin”, u shpreh Spiropali.

Pas diskutimit interaktiv me qëllim nxitje, përfshirjen qytetarëve në diskutim për buxhetin 2025, përfaqësuesit e Bashkisë bënë me dije banorët se çdo kërkesë, ankesë dhe sugjerim i tyre ishte i vlefshëm dhe do të shqyrtohet për t'u implementuar në buxhetin e Bashkisë Kamëz 2025.





